



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## STATUT I SHOQUERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"Bregu Company" sh.p.k

**Parashikimet e ketij Statuti zbatohen per nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (shpk).**

Ne kete statut

- "Ligji" eshte Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoquerite tregtare";
- "Statuti" eshte Statuti i shoqerise;

### Kreu I

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia dhe Adresa e Fakes se Internetit**

#### Neni 1: Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- (1) Sot, me 24.03.2018, une, themeluesi, kam krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin "Bregu Company" sh.p.k.
- (2) Themeluesit e shoqerise jane (mbiernrat, ernrat ose forma dhe emri ligjor i shoqerise; adresat ose selia e nurnri dhe vendi i regjistrimit):
  - - **Amarildo Bregu**, lindur me 15.06.1990, ne Patos-Fier, dhe banues ne Fier, krijon shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "Bregu Company" sh.p.k me ortaku i vetem adresë ne Fier, : **lagja Koferanca e Pezes, Rruga Jakov Xoxa, Ndertesa nr.49 ,kati 6 , Hyrja 15 , Apartamenti 45**

#### Neni 2: Objekti

#### **Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtern (veteri nese eshte i percaktuar):**

Tregtim materiale ndertimi dhe vegla pune.Ofrim sherbime internet,Punime hidraulike,Punime termoizoluese.Stampim fotografish.Shtypshkrime te ndryshme.Postera,reklama,stampime ne bluza,etj.Tregtim materiale elektronike(kompjutera,fotokopje,printera,etj).Punime ne fushen e ndertimit tregetimin e zhavorit,cakull,cimento,etj .Prodhim dhe montimduralumini.Punime elektrike.Tregtim materialesh elektrike.Suport IT.Riparime kompjutera,fotokopje,printera.Tregtim materiale higjeno-

sanitare.Punime druri dhe melamine dhe konstruksione metalike.Tregtim bime.lule.drure dekorative dhe tregtim pjese kembimi per automjete te ndryshme. tregti me pakice te materialeve hidraulike,pompa,sarqineska,tubo valvula rregullator presioni si dhe cdo gje tjeter.Tregetim materiale industriale .Tregetim Makineri

pune. Tregetim sisteme ngrohje soba ngrohje , chiller , pelet etj , montim dhe kolaudim tregetim artikuj kancelarie, bojra leter

printerasht etj. Tregetim gaze te lemgeshem per gatim si dhe gazrash teknike si dhe paisje nen presion kualidim te bomblave te gazite per gatim .Tregetim artikuj ushqimor me shumice dhe pakice .Tregetim dhe prodhim rroba pune , uniforma te ndryshme.

Tregetim inpute bujqesore si dhe pesticidesi plera kimik dhe organik ure dap,nitrat reudap.

Tregetim automjete te ndryshme, Transport me kamion te reres bituminoze Tregetim Foni dhe paisje audio vizive ,sinjalistike rrugore , Shitje pajisje kompjuterike,Eksport,Import si dhe tregti me shumice dhe pakice te pajisjeve elektronike informatike telekomunikacionit,sisteme vezhgimi, akses kontrolli,sisteme kundra zjarrit pjese kembimi dhe aksesore. Dizinfektant si koler plur dhe leng , gelqere plur dhe leng, riparime elektrike, UPS, Invertera bateri ,transport mallrash te ndryshme,Ndricim rrugor dhe Led, Shtrime te linjave te telekomunikacionit si; fiber optike, linja me kapacitete 5, 10,15, 20, 50,100 kopje etj. Shtrime te linjave elektrike, etj.

Tregetim ,riparim pompa, ashensore , paisje per zjarrefikese,gjelberim te ambienteve per entet publike dhe private,tregetim goma te ndryshme per automjete dhe kamicin. Rikonstruksione, ujesjellesa, kanalizime, lyerje objektesh si dhe instalimet e nevojshme per to, vepra kullimi, ujite tokash dhe impjante vaditese. Tregtim me shumice dhe pakice te te gjitha produkteve bujqesore. punirne te ndryshme ne bujqesi (mbjellje. korrie, shirje etj) Eksport-import. shitje me shumice dhe pakice e mjeteve bujqesore me ose pa zinxhire. te kapaciteteve te ndryshme, me ose pa rimorkio, makineri pajisje industriale. Eksport-import, shitje me shumice dhe pakice e te gjitha llojeve te pjesave te kembimit. te reja dhe te perdonura per automjete te transports tokesor, detar, ajror,desing lulishtesh, furnitura fidanesh, mirembajtje ambjentesh, elektro-shtepiake te te gjitha llojeve, mobilim per shkolla dhe universitetet, spitale, zyra, sala konferencash burgje, portet dhe aeroportet, matersa uji .Ndertime per n/stacionet kabinat e transformatoreve e linjat e tensionit te mesem, dhe shperndarjen e energjise .Impiante hidrosanitare kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre. Punirne rifiniture te

muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese. Impiante te sinjalistikes ndriçuese te trafikut. Sinjalistike rrugore jo ndriçuese. Bariera dhe mbrojtje rrugore. Punime germimi.ngjeshje dhe shtytje te dherave si dhe plerave te grumbulluara. Kualidim objektesh.Sherbim siguracioni per automjetet. Import – Eksport automjete te te gjitha llojeve te tonazheve,tregtim per automjete dhe dhenie me qera per automjete,tregtim per pjese kenbimi per automjete.tregetim te paisjeve te punes si sharra ,korrese bari,troko.punto si dhe mirembajtja e tyre. Import – eksport dhe tregtim me shumice dhe pakice te materialeve te ndertimit, te produkteve elektro – shtepiake dhe te makinerive industrial, te materialeve per ujesjellesa dhe

kanalizimeve, te materialeve elektrike, te materialeve hidraulike, te metrazheve dhe uniformave te punes dhe te veshmbathjeve, te lendeve drusore dhe I aksesoreve per prodhim mobiljesh, te pastrimit, te artikukjve ushqimore, te kompjuterave, printer, skaner, fotokopje, kondicioner dhe materialeve kancelarike. Transport udhetaresh dhe mallera te ndryshme Brenda dhe jashte Shqiperise. Sherbime ne fushen ndrizmit, agjensi udhetimesh turistike hotelirere – turizem restorante, ndertim resort dhe fshatra



turistik.Tregetim, riparim pompa, ashensore, pajiisje per zjarrefikese, Rikonstruksione, ujesjellesa, kanalizime, lyerje objektesi si dhe instalimet e nevojshme per to, vepra kullimi, ujite tokash dhe impjante vaditese. Tregtim me shumice dhe pakice te te gjitha prodhukteve bujqesore bar,fidan, Plera kimik-pesticide te ndryshme.Shitje me shumice dhe pakice e te gjitha llojeve te vajrerave, baterive, te pjeseve te kembimit,te reja dhe te perdonura per automjete te transportit tokesore,detar, ajror, desing lulishtesh, furniture fidanesh, mirembajtje ambientesh, elektro – shtepiake te te gjitha llojeve

### **Neni 3: Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me shume se 10 vjet:

### **Neni 4: Selia, Adresa e Fakes se Internetit (nese ka) dhe Adresa Elektronike (nese ka)**

- (1) Selia kryesore e shoqerise ndodhet ne adresen: Fier, : **lagja Koferanca e Pezes, Rruga Jakov Xoxa, Ndertesa nr.49 ,kati 6 , Hyrja 15 , Apartamenti 45**
- (2) Adresa e fakes se internetit te shoqerise eshte : amarildobregu005@gmail.com
- (3) Adresa e shoqerise per qellime komunikimi elektronik eshte si vijon.

### **Kreu II**

### **Kapitali i Regjistruar**

### **Neni 5: Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar**

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqerise do jete pas rregjistrimit ne QKB 10 000 Leke (te pakten 100). Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te me poshtme:

1. Ortaku themelues **Amarildo Bregu :**

lloji i kontributit: monedhe dhe vlera e kontributit 10000; kuota e zoterimit te kapitait te shoqerise 100%



(2) Kontributet ne para do te paguhen plotesisht menjehere. Kontributet ne natyre do ti kalojne Shoqerise menjehere pas regjistrimit ne QKB.

(3) Pagesat e kontributeve ne para do te kryhet ne Illogariue numer prane Bankes Raifassen

**Neni 6: Kërkesa per te paguar kuotat dhe terheqja e kuotave te papaguara**

(1) Administratoret mund t'u kerkojne ortakeve te shoqerise pagesen e kontributeve te pashlyera ne lidhje me kuotat e tyre dhe cdo ortak (pas marrjes se njoftimit prej \*30\* diteve kalendarike), ne te cilin percaktohet koha dhe vendi i kryerjes se pageses) i paguan shoqerise shumen e kerkuar per kuotat e zotruara. Njoftimi per pagese mund te parashikoje shlyerjen me keste te kontributeve te papaguara. Personi te cilit i drejtohet njoftimi per pagesen e kontributit do te jete perjegjes per njoftimet qe i drejtohen atij pavaresisht kalimit te mepasshern te pronesise se kuotave me te cilat lidhet njoftimi per pagese.

(2) Zoteruesit e perbashket te nje kuote do te jene perjegjes bashkerisht dhe ne menyre solidare per shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit te mesiperm.

(3) Ne rast se pas njoftimit per shlyerjen e kontributeve pagesa perkatese nuk kryhet brenda afatit te parashikuar, personi perjegjes per shlyerjen e kontributeve do te paguaje nje interes mbi shumen e papaguar me nje kamatevoneze prej perqindjes sipas interesave te bankes se shqiperise ne vit duke filluar nga dita e parashikuar per pagesen,

(4) Ne rast se pas njoftimit per shlyerjen e kontributeve, pagesa perkatese nuk kryhet brenda afatit te parashikuar, Administratoret mund te njoftojne paraprakisht te pakten \*7\* dite kalendarike personin perjegjes per shlyerjen e kontributeve, duke i kerkuar pagesen e shumes se pashlyer se bashku me shumat e mundshme shtese te kamatevoneses. Njoftimi do te permbate vendin ku duhet te kryhet pagesa dhe deklarimin se ne rast mosbatimi te tij, kuotat te cilave u referohet njoftimi do te anulohen.

(5) Nese pagesa nuk kryhet brenda afatit te njoftimit, kuota me te cilin lidhet njoftimi, perpara se te kryhet pagesa e kerkuar sipas njoftimit, mund te anulohet me vendim te Asamblese dhe anulimi do te perfshi te gjithe dividendet ose shumat e tjera te pagueshme ne lidhje me kuotat e anuluara dhe te papaguara deri ne momentin e anulimit.

(6) Ne pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anluar mund te shitet, rishperndahet ortakeve ose te kalohet sipas afateve dhe menyrave qe Administratoret konsiderojne te pershatshme.

(7) Personi, kuota e te cilit eshte anluar, humbet cilesine e ortakut ne lidhje me kete kuote por do te jete perjegjes ndaj shoqerise per te gjitha kontributet qe do te shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqerise ne daten e anulimit te kuotes se bashku me kamatevonesen e llogaritur per keto kontribute perpara anulimit te kuotes.

**Neni 7: Llojet e Kuotave, te Drejtave dhe Kufizimeve**

Ne perputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cenuar te drejtat qe rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund te emetojen me te drejtat ose kufizimet e parashikuara ne vendimin e Asamblese se Pergjithshme, te rnarre me shurnicen e kualifikuar (tre te katertat) te votave se ortakeve, ne perputhje me parashikimet e Nenit 87 te Ligjit 9901.

**Neni 8: Certifikatat e kuotave**

Secili ortak ka te drejte te perfitoje nje certifikate per kuoten e zoteruar prej tij. Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje certifikate per kuotat e zoteruara bashkerisht nga disa persona dhe dorezimi i certifikates ndaj perfaqesuesit te zoteruesve te perbashket te kuotave do te konsiderohet si dorezim i kryer ndaj te gjithe zoteruesve te kuotave, ne perputhje me piken 2 te nenit 72 te Ligjit. Emrat e zoteruesve te perbashket te kuotave do te renditen ne certifikaten e kuotes. Certifikata nuk do te gezoje cilesine e letres me vlere.

**Neni 9: Menyrat e fitimit dhe kalimit te kuotave**

1. Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- 9) dhurimit;
- d) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

2. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

\*Shenim: \*Statuti mund te kushtezoje kalimin e kuotave, vecanerisht duke percaktuar miratimin e shoqerise ose te drejten e parablerjes ne favor te shoqerise apo te ortakeve te tjere".

**Neni 10: Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit Themeltar**

(1) Asambleja e Pergjithshrn, me shumice te kualifikuar, mund te zrnadhoje kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ne shumen e percaktuar ne vendimin perkates. Zmadhimi i kapitalit me qellim pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, miratohet nga Asambleja e Pergjithshrn me shumicen e kualifikuar te votave te ortakeve.

(2) Shoqeria mund te vendose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise me vendimin e Asamblese se Pergjithshrn, te marre me shumicen e kualifikuar te votave.

**Nelli 11: Blerja e Kuotave te Veta**

(1) Shoqeria mund te bleje kuotat e veta dhe te kryeje pagesa per blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqerise qe do t'u shperndahen ortakeve apo emetimi i kuotave te reja veterne nese shoqeria permbush kushtet per shperndarjen e fitimeve sipas nenit 77 te Ligj it dhe Administratoret leshojne nje certifikate te aftesise paguese te parashikuar nga ky nen. Ne rast se blerja e kuotave te veta nuk eshte ne perputhje me kushtet e nenit 77 te Ligjit, padite mbi perjegjesine e shoqerise mund te ngrihen ne pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 te Ligjit "Per tregtaret dhe shoqeritet tregtare".

**Kreu III**

## Asambleja e Pergjithshme

### Neni 12: Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

(1) Administratoret therrasin Asamblene e Pergjithshme dhe, me kerkesen e ortakeve sipas Nenit 84 te Ligjit, do te procedojne me thirrjen e Asamblese se Pergjithshrn.

(2) Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nepermjet një njoftimi te derguar me poste ose poste elektronike (email) drejtuar cdo ortaku, perfshire edhe perfaqesuesin e kuotave ne zoterim te perbashket. Njoftimi me shkres apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Secilit ortak, se bashku me njoftimin per mbledhjen, dergohet edhe numri PIN per te mundesuar pjesemarrjen dhe votimin elektronik ne mbledhje.

(3) Kur asambleja e per gjithshrn nuk eshte thirrur sipas pikes Ite ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme veterne nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

### Neni 13: Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme

(1) Asambleja e Pergjithshme merr vendime te vlefshme veterne me arritjen e kuorumin te parashikuar nga neni 86 i Ligjit. Ortaket ose perfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjese nepermjet mjeteve elektronike, perfshire telekonferencen (conference call), audio ose audio-video, ne perputhje me nenin 88 te Ligjit. Ortaket qe marrin pjese me mjete komunikimi elektronik kane te drejte te votojne nepermjet nurnrit PIN qe iu eshte derguar se bashku me njoftimin per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme.

(2) Adrninistratoret caktojne Kryetarin e mbledhjes si edhe një person per te mbajtur procesverbatin e saj.

(3) Nese asnje prej Administratoreve nuk deshiron te caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nese asnje prej Administratoreve nuk eshte i pranishem per pesernbedhjete minuta duke filluar nga ora e caktuar per fillimin e mbledhjes, ortaket e pranishem dhe me te drejte vote zgjedhin njerin prej tyre si Kryetar te mbledhjes.

(4) Administratori, pavaresisht se nuk eshte ortak, ka te drejten e pjesernarrjes si edhe te marre fjalen ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme.

(5) Kryetari, me pelqimin e Asamblese se Pergjithshme te mbledhur ne perputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe eshte i detyruar nese kerkohet nga Asambleja e Pergjithshrn), te shtye mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, por ne mbledhjen e dyte mund te diskutohen veterni ato ceshtje te cilat do te ish in diskutuar rregullisht nese nuk do te ishte shtyre mbledhja e meparshme. Kur mbledhja e Asamblese se Pergjithshme shtyhet, njoftimi do ti degohet gjithe ortakeve jo me vone se shtate dite perpara dates se caktuar dhe ne te do te percaktohet ora dhe vendi i mbledhjes se shtyre dhe pershkrimi i per gjithshern i rendit te dites. Ne rast te kundert, dhenia e njoftimit nuk eshte e nevojshme.

(6) Asambleja vendos me votim te hapur me perjashtim te rastit kur perpara ose gjate deklarimit te rezultatit, nuk kerkohet ne menyren e duhur nje votim i fshehte. Votimi i fshehte mund te kerkohet nga:  
1. Kryetari; ose

2. nje ortak ose ortaket qe perfaqesojne te pakten pese per qind te kapitalit themeltar te shoqerise. Kerkesa e bere nga nje perfaquesues i autorizuar i ortakut ka te njejten vlore me kerkesen e paraqitur nga vete ortaku.

(7) Me perjashtim te kundershtimit te nje ortaku, deklarimi i Kryetarit se vendimi eshte marre ne menyre unanime, ose me nje shumice te caktuar, nuk eshte miratuar ose nuk eshte miratuar me nje shumice te caktuar dhe regjistrimi perkates ne procesverbalin e mbledhjes perben prove perfundirntare te ketij fakti, pa pasur nevoje per numerimin e votave te regjistruara pro ose kunder vendimit.

(8) Ne rast se ka kundershime per kete deklarate, do te zhvillohet nje votim fshehte ne lidhje me percaktimin e numrit te votave pro dhe kunder vendimit.

#### Neni 14: Votat e Ortakeve

(1) Ne perputhje me te drejtat ose kufizimet qe rrjedhin nga kuotat, cdo kuote i jep ortakut (ne rastin kur eshte individ) te pranishern apo perfaquesuesit te tij te autorizuar ose ortakut (ne rastin kur eshte person juridik) i cili eshte i pranishern permes perfaquesuesit ligjor apo perfaquesuesit te autorizuar ne menyre te rregullt, te drejten e nje vote.

(2) Cdo kundershtim ne kohe per cilesine e nje votuesi do ti komunikohet Kryetarit, vendimi i te cilit do te jete perfundimtar.

#### Neni 15: Votimi me Prokure

(1) Perfaquesuesi do te ernerohet nga ortaku sipas formes se meposhtme (ose ne formen e zakonshme apo formen qe mund te miratohet nga Administratoret):

"..... SHPK.....

Une/Ne i/te nenshkruari/t,.....ne cilesine e ortakut/ortakeve te shoqerise se lartpermendur, emeroj/rne ....., ose ne parnundesi te tij, , ne cilesine e perfaquesuesit/ve tirn/tone per te votuar ne erner/ernrat rim/tone dhe ne llogarine time/tone ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshrn te shoqerise e cila do te mbahet me \*data/muaji/ viti\* dhe ne cdo mbledhje te shtyre. Nenshkruar me \*data/muaji/ viti\* .

(2) Ne rastet kur deshirohet tu jepet ortakeve rnundesia per te udhezuar perfaquesuesin per menyren veprimit, caktimi i perfaquesuesit behet sipas formes se meposhtme (ose ne formen e zakonshme apo formen qe mund te miratohet nga Adrninistratoret): " SHPK . Une/Ne i/te nenshkruari/t, , ne cilesine e ortakut/ortakeve te shoqerise se lartpermendur, emeroj/rne ....., ose ne pamundesi te tij, , ne cilesine e perfaquesuesit/ve tim/tone per te votuar ne emer/ernrat tim/tone dhe ne llogarine time/tone ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te shoqerise e cila do te mbahet me data Imuajil viti dhe ne cdo mbledhje te shtyre. Kjo forme do te perdoret per vendimet e permendura me poshte: Vendimi Nr. 1 \*pro =kunder Vendimi Nr. 2 \*pro \*kunder. (\*Fshini zgjedhjen e padashiruar). Pervec udhezimeve te tjera, perfaquesuesi mund te votoje ose abstenje, sic e quan te arsyeshme. Nenshkruar me \*data/muaji/ viti\*

(3) Caktimi me shkrim i perfaquesuesit ose nje kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratoret depozitohet ne seline e shoqerise ose ne nje vend tjeter brenda territorit te Republikes se Shqiperise, sic percaktohet ne njoftimin per mbledhjen e Asarnblese se Pergjithshrn te shoqerise ose ne ftesen per te caktuar nje perfaquesues te derguar nga shoqeria ne lidhje me mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme. Akti i

ernerimit te perfaqesuesit duhet te depozitohet jo me vone se 48 ore perpara ores se mbledhjes ose mbledhjes se shtyre, ne te cilen duhet te votoje perfaqesuesi.

(4) Ne rast se akti i emerimit te perfaqesuesit jepet neperrnjet komunikimit elektronik te derguar ne adresen elektronike (email) sipas percaktiemeve te pikes 3 te nenit 4, te ketij Statuti, ky akt duhet te merret jo me vone se 48 ore perpara ores se mbledhjes ose mbledhjes se shtyre ne te cilen duhet te votoje perfaqesuesi.

#### **Neni 16: Perjashtimi nga e drejta e votes**

(1) Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;

C;) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

(2) Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

#### **Neni 17: Hetimet e posacme**

Personi ose person at qe plotesojne kushtet per te kerkuar ernerimin apo zevendesimin e nje eksperti te fushes sipas nenit 91 te Ligjit paraqesin nje kerkese te tille nepermjet depozitimit te nje deklarate notoriale ne seline e shoqerise e cila verteton se personi ose personat plotesojne kushtet per kryerjen e ketij veprimi.

**Kreu IV**  
**Administratoret**

#### **Neni 18: Emerimi i Administratoreve**

(1) Asambleja e pergjithshme ernereron nje ose me shume persona fizike si admrinistratore te shoqerise. Afati i ernerimit, eshte 5 vjet, me te drejte riparteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

(2) Administratoret e nje shoqerie tregtare merne, sipas percaktimit te Nenit 207 te Ligjit 9901, nuk mund te ernerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Cdo ernerim i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshern.

(3) Personat e meposhtern caktohen si Administratore te pare te shoqerise deri ne ernerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshre. Te dhenat e identifikimit: dhe specimenet e nenshkrimi: (mbiemrat, emrat, adresat): . Amarildo Bregu , Fier

(4) Administratori Amarildo Bregu do te caktohet si Kryetar i mbledhjeve te Administratoreve deri ne zgjedjen nga mbledhja e pare e zakonshme.

#### **Neni 19: Kompetencat e Administratoreve**

Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshre;



- b) perfaqesoj ne shoquerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoquerise;
- 9) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimitarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se per gjithshnre per miratim;
- d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimitarise dhe ekzistencen e shoquerise;
- dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoquerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regj istrimit;
- e) raportojne perpara asamblese se per gjithshnre ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacrne me rendesi te vecante per veprimitarine e shoquerise tregtare;
- e) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur: -sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoquerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim. -shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoquerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara. -shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoquerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese asambleja e per gjithshme erneron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoquerine.

Asambleja e per gjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoquerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

#### **Neni 20: Perfaqesimi**

- (1) Kufizimet e tagrave te perfaqesimit te administratoreve i kundrejtohen paleve te treta, ne perputhje me dispozitat e nenit 12 te Ligj it 9901.
- (2) Administratoriet, qe perfaqesojne bashkerisht shoquerine tregtare, mund te autorizojne disa prej tyre per kryerjen e disa veprimeve te caktuara apo per kryerjen e disa kategorive te caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratoreve jane te vlefshme e detyruese per shoquerine.
- (3) Tagrat e perfaqesimit te administratoreve dhe cdo ndryshim i tyre njoftohen per regj istrim prane Qendres Kombetare te Regj istrimit.

#### **Neni 21: Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratoreve**

Detyra e Administratorit perfundon ne rast se:

1. personi nuk eshte me Administrator sipas parashikimeve te Ligjit perfshire edhe parashikimet e pikes 6 te Nenit 95 te Ligjit "Per tregtaret dhe shqoerite tregtare":
2. personi ndodhet ne gjendje paaftesie paguese;
3. personi yuan ose mund te vuaje nga crtegullirne mendore;
4. personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar shoquerine, ose

5. ka munguar per me shume se gjashte muaj radhazi pa lejen e Administratoreve te tjere ne mbledhjet e Administratoreve te mbajtura gjate kesaj periudhe dhe Asambleja e Pergjithshme, me propozimin e Administratoreve, vendos ta shkarkoje nga detyra.

#### **Neni 22: Shperblimi, Perfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratoreve**

- (1) Administratoret shperblehen ne baze te skernes se vendosur nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me parashikimet e Nenit 97 te Ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
- (2) Asambleja e Pergjithshme mund te parashikoje perfitime, nepermjet shperblimeve ne para, pensione, sigurime ose forma te tjera, per cdo person i cili ka qene por nuk eshte me ne detyre apo i punesuar ne shoqeri, shoqeri te tjera te cilat jane ose kane qene shoqeri te kontrolluara ose per shoqeri paraardhese te shoqerise ekzistuese ose te filialeve te saj, ose per cdo familjar te tyre (perfshire bashkeshorin/en, ish-bashkeshorin/en) ose persona te cilet jane ose ishin ne varesi te tyre, dhe mund te paguaje kontribute ne fonde te caktuara per dhenien e perfitimeve te tilla.
- (3) Administratoreve mund t'i paguhen te gjitha shpenzimet e udhetimit, akomodimit dhe shpenzime te tjera ne lidhje me pjesernarrjen e tyre ne mbledhjet e Administratoreve ose te komiteteteve te Admninistratoreve ose te Asamblese se Pergjithshne ne lidhje me permbushjen e detyrave te tyre.

#### **Neni 23: Mbledhjet e Administratoreve**

- (1) Mbledhjet e Administratoreve do te mbahen sipas nevojave te aktivitetit tregtar te shoquerise. (2) Asambleja e Pergjithshme cakton njerin prej Administratoreve me detyren e Kryetarit te mbledhjes se Administratoreve, i cili mund te shkarkohet ne cdo kohe nga kjo detyre. Kryetari do te drejtoje cdo mbledhje te Administratoreve ne te cilat ai eshte i pranishern. Ne rast se Kryetari nuk deshiron te drejtoje mbledhjen apo nuk eshte i pranishem brenda pese minutave nga ora e caktuar per mbledhjen, Administratoret e pranishern mund te emerojne njerin prej tyre si Kryetar te mbledhjes.
- (3) Ceshtjet e rendit te dites vendosen me shumicen e votave te pjesernarresve. Ne rast numri te barabarte votash, vota e Kryetarit do te jete vendimtare.
- (4) Te gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Admninistratoreve, ose nga një komitet i Administratoreve, apo nga persona te cilet veprojne si Administratore, pavaresisht nese behet e ditur me vone se ka pasur rnangesi ne ernerimin e një Administratori ose njeri prej tyre ka qene i skualifikuar nga mbajtja e kesaj detyre, ose nuk kishin te drejte te votonin, do te konsiderohen te vlefshme njelloj sikur keta persona te ishin erneruar rregullisht dhe te ishin cilesuar e te vazhdonin detyren si Administratore dhe te kishin te drejte te votonin ne mbledhje.
- (5) Vendimi me shkrim i nenshkruar nga te gjithe Administratoret qe kane te drejte te njoftohen per mbledhjen e Administratoreve ose nga k komiteti i Administratoreve do te konsiderohet si i vlefshern dhe i efektshern njelloj si te ishte miratuar ne mbledhjen e Administratoreve, e mbledhur dhe e zhvilluar rregullisht.

#### **Neni 24: Kufizimet ne Votimet e Administratoreve**

- (1) Administratoret nuk do te lidhin marreveshje ose votojne ne mbledhjen e Administratoreve per ceshtje ne te cilin keta anetare kane, direkt ose indirekt, nje interes apo detyrim i cili eshte material, qe eshte apo mund te jete ne kundershtim me interesat e shoquerise, ne pajtim me nenin 13 te Ligj it

9901, deri ne momentin kur ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshre, te gjithe anetaret kane rene dakord qe:

- te autorizojne lidhjen e kesaj rnarreveshje dhe
- te autorizojne kete anetar qe te votoje ne lidhje me kete ceshtje. Autorizimi mund te jeti i per gjithhem ose i posacem per nje ceshtje te caktuar. Autorizimi i per gjithshern duhet te regjistrohet prane Qendres Kornbetare te Regjistrimit.

(2) Vota e Administratorit nuk do te llogaritet ne kuorumin e pjesernarresve ne mbledhje ne lidhje me vendimin per te cilin ky anetar nuk ka te drejte te votoje. Dispozitat e nenit 89 te Ligjet "Per tregtatert dhe shoqerite tregtare" do te zbatohen lidhur me perjashtimin e Administratorit nga vendimet e marra ne kete mbledhje.

(3) Ne rast se ne mbledhjen e Administratoreve ose te komitetit te Administratoreve diskutohet nje ceshtje e lidhur me te drejten e votes se nje Administratori, ceshtja mund ti drejtohet Kryetarit te mbledhjes, perpara perfundimit te mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me cdo Administrator te ndryshem nga ai vete do te jete perfundimtar dhe i formes se prere.

#### **Neni 25: Prosesverbalet e Mbledhjeve te Administratoreve**

Administratoret kujdesen qe ne libra te posacern te mbahen procesverbalet e:

1. te gjitha takimeve te kryera nga Adrninistratoret; dhe
2. te gjitha mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshre, mbledhjeve te Administratoreve dhe komiteve te Administratoreve, perfshire edhe emrat e Adrninistratoreve te pranishem ne keto mbledhje.

#### **Krell V**

#### **Dividendet dhe Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar**

#### **Neni 26: Dividendet (I)**

Pas plotesimit te parashikimeve te Nenit 77 te Ligj it 990 I, shoqeria me shumice te kualifikuar te votave se Asamblese se Pergjithshme mund te deklaroje shperndarjen e dividendeve ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.

(2) Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe lidhen me kuotat, te gjithe dividendet deklarohen dhe paguhen ne perputhje me shumat e paguara per kuotat per te cilet paguhet dividendi. Te gjithe dividendet pjesetohen dhe paguhen ne perpjasetim te drejte me shumat e paguara per kuotat, pjeses ose pjeseve te periudhes per te cilen paguhet dividendi; ne rast se kuota emetohet me kushtin e perfitirnit te dividendifit nga nje date e caktuar, dividendi do te paguhet ne perputhje me kete kusht.

(3) Asnjë dividend ose pagese ne para qe lidhet me nje kuote nuk do te mbarte interesa ndaj shoqerise nese nuk parashikohet nga te drejtat qe lidhen me kuoten.

#### **Neni 26: Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar**

Administratoret, pas vendimit te marre nga Asambleja e Pergjithshme me shumice te kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh pari met e percaktuara ne nenin 14 te Ligj it 9901, mund te vendosin te kalojne ne kapitalin themeltar te shoqerise fitimet e pashperndara te cilat nuk do te perdoren per te

paguar dividende preferenciale apo shuma te tjera te parashikuara per rezervat e kapitaiit te shoqerise.

**Krell VI**  
**Prishja dhe njoftimet**

**Neni 27: Prishja dhe likuidimi Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar prishet:**

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelin e saj;
- b) me vendim te asamblese se per gjithshme;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ~) nese nuk ka kryer veprimitari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimitarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- d) me vendim te gjykates:

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi. Rregullat per proceduren e zakonshme te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese jane Nenet 191 deri ne 203 te Ligjit 9901. Shoqeria likuidohet me procedure te thjeshtezuar, ne perputhje me Nenet 204 dhe 205 te Ligjit 9901.


**Neni 28: Njoftimet**

(1) Njoftimet e kryera nga cdo person sipas parashikimeve te Statutit, duhet te jene me shkrim ose (nese zbatohet) nepermjet komunikimit elektronik ne adresen e parashikuar sipas pikes 3 te nenit 4 te ketij Statuti dhe jane te vlefshme ne lidhje me kohen e njoftuar per kete qellim dhe person in qe kryen njoftimin.

(2) Shoqeria mund te njoftoje nje ortak personalisht ose duke e derguar njoftimin me leter porosi me kthim per gjigje ne adresen e regjistruar te ortakut ose ne adresen apo posten elektronike (nese ka) qe i eshte njoftuar shoqerise nga ortaku. Kur ka disa bashkezoterues te nje kuote, te gjitha njoftimet ijepen perfaquesuesit te tyre te perbashket ne perputhje me piken 2 te nenin 72 te Ligjit. (3) Ky Statut se bashku me ndryshimet dhe te gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhena nga shoqeria do te publikohet nga Administratoret ne faqen e internetit te shoqerise, sipas parashikimeve te pikes 2 te nenit 4 te ketij Statuti (nese zbatohet).

Emrat dhe nenshkrimet e Ortakeve Themelues:

Amarildo Bregu

  
\*Vendi \*Datamuaji/ Viti\*  
Fier me 24/03/2018  
